



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.91/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare Lirije Maksutaj e me Zyrtaren Ligjore Klatrina Citaku, në konfliktin administrativ të paditësit, NTP "R." me pronarin H.P. nga I. i kundër të paditurës, Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë, për shkak të heshtjes së organit të paditur, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve të thirrura në mënyrë të rregullt, me dt.31.10.2018, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, NTP "R." me pronarin me pronarin H.P. Komuna e I. dhe detyrohet e paditura, Ministria e Infrastrukturës që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të nxjerre aktin administrativ në ri-vendosje sipas kërkesës së paditësit, të dorëzuar tek e paditura me dt.23.12.2016 dhe të njëjtin, t'ia dorëzoj paditësit, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

E paditura, Ministria e Infrastrukturës, nuk ka dhënë përgjigje në padi sipas e aktvendimeve të kësaj gjykate, dt.23.03.2018 dhe 21.06.2018.

Gjykata në mungesë të dhënies se përgjigjes në padi por dhe të provave qe nuk janë bashkangjitur në shkresa të lëndës nga e paditura ne çështjen e paditësit ne respektim të parimit të efikasitetit nuk është hapur seancë dhe ftuar palët.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi më dt.23.12.2016, i është drejtuar të paditurës Ministrisë Infrastrukturës, me kërkesë për ri-shqyrtimin e lëndës duke u bazuar ne aktgjykimin e kësaj gjykatë të dt.06.10.2016 ne rivendosje, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar në afatin e caktuar ligjor e as më pas por as deri tani.

Sipas nenit 76 dhe 77 të Ligjit për Procedurën Administrative (Ligji 02/L-28) organi administrativ, në këtë rast e paditura, ka pasur obligim që të marrë vendim lidhur me kërkesën e paditësit, ndërsa e paditura në kundërshtim me ligjin, ka heshtur dhe nuk ka marrë vendim e as nuk i është përgjigjur në asnjë formë paditësit.

Me nenin 29 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se nëse organi i shkallës së dytë, në afatin prej 30 ditësh, nuk merr aktvendim sipas ankesës-kërkesës, e këtë nuk e bënë as në afatin tjetër prej 7 ditësh, pas paraqitjes së kërkesës së përsëritur, pala mund të fillojë kontestin gjyqësor, sikur ankesa-kërkesa të ishte refuzuar.

Meqenëse e paditura nuk ka marrë vendim as pas kërkesës së përsëritur të paditësit të dt.23.12.2016, gjykata vlerëson se paditësi me të drejtë ka iniciuar, kontestin gjyqësor kundër të paditurës, për shkak të heshtjes së administratës, meqenëse marrja e vendimit sipas ankesës së paraqitur dhe dorëzimi i saj, palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Me nenin 131.2 të Ligjit për Procedurë Administrative, është paraparë se në qoftë se me kalimin e afatit të parashikuar për ankim, nuk është nxjerrë asnjë vendim mbi ankimimin nga organi administrativ kompetent, palëve të interesuara, iu lindë e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, në përputhje me ligjin.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë vlerëson se në këtë çështje administrative-juridike, ligji është zbatuar në dëm të paditësit, kështu që në ri-procedurë, organi i paditur, do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditësit, do të vërtetoj faktet relevante dhe pastaj, do të marr një vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura, janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5, 6, 29 dhe 38, si dhe nenit 46.2, të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.91/2017 dt.31.10.2018

Zyrtare Ligjore
Kaltrina Çitaku

G j y q t a r j a
Lirije Maksutaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.